

Shtojca 1

Objektivat kyçe të projektit “Qelizat e reja/young cells” në Shqipëri

Një nga sfidat kryesore me të cilat përballlet Shqipëria është rritja e kapaciteteve të nëpunësve civilë të përfshirë në procesin e integritimit në BE. Përgjigjet e duhura për këtë sfidë janë përmirësimi i vazhdueshëm i kornizës administrative dhe praktikave të mira të menaxhimit për zbatimin dhe koordinimin e procesit të integritimit. Kështu, projekti do të adresojë nevojat dhe prioritetet e qeverisë së Shqipërisë, veçanërisht ato që lidhen me integrimin në BE, koordinimin e politikave dhe mbështetje në vendimmarrje.

Në kuadër të gjithë këtyre elementeve, objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të një administrate publike profesionale, efikase dhe transparente në Shqipëri, nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të një programi praktike dedikuar nëpunësve të rinj civilë shqiptarë.

Projekti do të përmirësojë kapacitetet profesionale dhe ekspertizën e një grupi prej 25 nëpunësish civilë në sektorë kyç të administratës publike shqiptare, duke u ofruar atyre mundësinë për të ndërmarrë trajnime praktike, seanca mentorimi, vizita studimore dhe praktika në shkollat dhe administratat publike të shteteve anëtare të BE-së. Njohuritë dhe aftësitë praktike që këta nëpunës civilë do të përvetësojnë, do t'u mundësojnë atyre të kontribuojnë plotësisht në përpjekjet e qeverisë shqiptare për të përmbushur detyrimet dhe sfidat që dalin nga procesi i integritimit në BE.

Projekti synon gjithashtu të zhvillojë mekanizma të qëndrueshëm që mbështesin zhvillimin e karrierës së nëpunësve të rinj civilë të aftësuar, duke u mundësuar atyre të japin një kontribut kuptimplotë në reformat kryesore dhe duke i bërë ata agjentë të ndryshimit për një administratë publike shqiptare më efikase dhe inovative. Kështu, projekti synon të mbështesë qeverinë shqiptare në përdorimin më të mirë të aftësive të përmirësuarë të të trajnuarve. Gjithashtu, të nxitet rrjetëzimi dhe *esprit de corps* midis të diplomuarve të programit, për të promovuar shkëmbimin e qëndrueshëm të përvojave duke i ndarë me kolegët brenda shërbimit civil. Së fundi, informacioni për Reformën në Administratën Publike dhe integrimin në BE do të ndahet përmes eventeve promovuese dhe aktiviteteve të rrjetëzimit.

Nëpërmjet zbatimit të një programi gjithëpërfshirës kushtuar nëpunësve të rinj civilë që përfshin trajnime, mentorim, praktikë dhe vizita studimore në administratat publike të vendeve anëtare të BE-së, projekti “Qelizat e reja/young cells” do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të një administrate publike profesionale, efikase dhe transparente. Kështu, projekti pritet të forcojë kapacitetet e administratës publike shqiptare në përputhje me prioritetet e qeverisë dhe anëtarësimin në BE.

Projekti do të zbatohet nga një konsorcium i udhëhequr nga Instituti Kombëtar i Shërbimit Publik Francë (INSP), me Universitetin e Kehl (UASK), në Gjermani, Universitetin e Bolonjës (UNIBO) dhe rajonin Emilia-Romagna në Itali, si bashkë-aplikues. Qendra Kombëtare për Administratën Publike dhe Qeverisjen Vendore të Greqisë (EKKDA) dhe Shkolla Kombëtare e Administratës Publike (NSPA) e Kroacisë janë partnerë bashkëpunëtorë. INSP ka përgjegjësinë e menaxhimit dhe raportimit për projektin në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU) Ministria e Financave dhe Ekonomisë në Shqipëri.